

HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



# FOREVER

11. 2013 :: XVII. Issue 11.



# LONDON'S CALLING

**OUR TEAM:**

**2000**

**PEOPLE**

**2014**  
GLOBAL RALLY  
LONDON  
27 APRIL - 5 MAY

[www.foreverglobalrally.com](http://www.foreverglobalrally.com)



*Rex Maughan*

**Rex Maughan**  
I juaji

## E dashur familje Forever!

Kur fillon e freskohet koha dhe fillojnë të bien gjethet , gjithmonë kam qejf të drejtohem për në veri, në skajet e Arizonës së mrekullueshme. Duke ndenjur atje, po mendoja çdo të thotë Forever, si markë. Marka të fuqishme me emër si Apple apo Coca-Cola të sjellin në mendje një imazh të njohur. Kur mendon për Foreverin si markë, të vjen ndërmend se është një firmë që ka njerëz në gjithë globin të cilët kanë përqafuar një mënyrë jetese të sukseshme dhe të shëndetshme. Duke lexuar ndesha një poemë të Weldon Rutledge që flet për rëndësinë e markës. Ai shkruan se edhe kur kemi përpara një detyrë sfiduese, ne duhet të kemi besim tek marka jonë dhe të vazhdojmë të jemi „besnikë të markës.”

Çdo të thotë për ty Forever? Komunikimi i kuptimit që fshihet pas markës Forever tek Distributorët tuaj, do ti ndihmojë ata të kuptojnë se janë pjesë e Familjes Forever.

Shumë nga ju e dini se unë jam rritur në një fermë, kështu që „besnik i markës”, për mua personalisht ka një kuptim të madh. Në origjinë ajo ka qënë shprehje e cowboys-ave. (Në jetën e cowboys-ave kjo shprehje do të thoshte përgjegjësi, shpërblim i merituar, besim, bashkim dhe mishërim i vlerave të punës në grup. Për ata kjo do të thoshte themel i suksesit të individit dhe të bashkësisë të tyre.)

Babai më mësonte të punoja fort dhe gjithmonë më thoshte: ”Një kuletë bosh është më lehtë “ta kurosh” se sa ta durosh”. Për suksesin nuk ka rrugë më të shkurtër se kaq. Inkurajoje skuadrën tënde të fokusohet në Parimin e Zhvillimit të Katër Parimeve Themelore (4Core) me qëllim që të përgatiten si drejtues të fortë. Kur ndiqni objektivat tuaja në Forever, ji i guximshëm, ji i fortë dhe “besnik i markës”!



# Përpara për fundvitin

**P**as pak kohësh na vjen fundi i vitit, gjithkush përgatitet për Mbylljen dhe natyrisht fillon me një urra të madhe. Nga mesi nëntorit fillojmë e mendohemi a kemi punuar mjaft, a kemi grumbulluar pikët e nevojshme për në Londër, apo kemi dhe një muaj e gjysëm përpara dhe jemi brenda, mbasi ne për një muaj e gjysëm zgjidhim atë që të tjerëve u duhen katër muaj. Për gjithkënd objektivi numer një është plotësimi i „sfidës të Londrës”, mbasi të takohesh me njëzet mijë rrejtandërtuesit më të mirë të botës, rrallë të jepet rasti, edhe për një forever. Nga këta njëzet mijë pjesmarrës, 10 përqind e përbëjmë ne hungarezët, serbët, kroatët, sllovenët, boshnjakët, shqiptarët, malazetët, dhe kjo tashmë është vetëm shkuma mbi tortë. Disa herë e kam siguruar Aidan O’Hare, zëvendës presidentin Foreverit për Eropën, se do të bëjmë gjithshka që në Global Rally-n e Londrës rajonin do ta përfaqsojmë me 2000 vetë, por premtimi im në vetvete është pak, sepse ka nevojë në unitet, të gjithë të jemi të përqëndruar tek flamuri i Foreverit, dhe të grumbullojmë pikët që duhen për në Londër.

Çdo distributor i foreverit motivimin më të madh në Global Rally e merr nga Rex-i, nga Gregg-u, nga Aidan, nga diamantët e sukseshëm dhe nga drejtuesit e tjerë. Kështu së bashku asgjë nuk mund të na pengojë. Në qoftë se vërtet kërkon diçka nga vetja dhe nga biznes, atëhere tash ky është një rast që nuk mund të lihet të humbasë. Shtro pyetjen do shkoj apo nuk do shkoj. Në qoftë se do të jesh i sukseshëm, atëhere pa mëdyshje duhet shkuar. Gjithkush që ka objektiva për vitet që vijnë, dhe ne kemi objektiva të mëdha për shitjet, vendin e ka atje. Rex, Gregg dhe Aidan me programin „Londra na thërret” ne europianëve na kanë dhënë një mundësi të veçantë në dorë. Mos rrini pasivë ndaj këtij programi, sepse ka akoma dhe një muaj e gjysëm që mund të regjistrohemi dhe prap të mund ta realizoni! Në Londër kemi nevojë për çdo dorë që duartroket dhe që thërret: Ria, ria Albania! A mund ta imagjini?

Dy mijë vetë nga të rajonit janë tanët! Nga numeri jemi të sigurtë se ne do të jemi grupi më i madh, sigurisht pas të zotëve të shtëpisë. Në qoftë se nga numeri jemi grupi më i madh, tash na duhet vetëm një hap që edhe nga shitjet ne të jemi të parët. Ta bëjmë edhe atë hap, dhe vitet 2014, 2015, 2016 do të jenë vitet e arta të Hungarisë dhe të rajonit të saj. Falnderoj veçanrisht bashkpunëtorët drejtues, që në takimin e Ditës së Suksesit qëndruan në mbështetje të programit të Londrës dhe së bashku u betuam që atje do të jemi dy mijë vetë, dhe për këtë do të punojmë pa u lëkundur, deri ditën e fundit, deri më 31 dhjetor. Unë aty jam me ju çdo ditë, më thërrisni po të kini nevojë, për të ndihmuar në arritjen e këtij qëllimi fisnik.

Si përfundim, por jo në radhë të fundit, ju bëj thirrje për marrjen e çmimit të entuziazmit „Spirit Award”, që ta fitojmë përsëri këtë çmim sepse e meritojmë!



**Dr. Sándor Miliesz**  
Drejtor i Përgjithshëm

Përpara, FLP Albania!



# HOLIDAY

PAS SHTATË TAKIMESH TË SUKSESHME NË POREC, HOLIDAY RALLY I TETË U ZHVILLUA NË NJË VEND TË RI, NË OPATIJA, ME EMRIN E DIKURSHËM ABBAZIA. KY QYTET I BUKUR, ËSHTË QËNDËR E RIVIERËS KVARNER, QË DIKUR KA QËNË VËND PUSHIMI I MONARKISË AUSTRO-HUNGAREZE DHE SOT ME TË DREJTË KONSIDEROHET NJË NGA PERLAT E KROACISË.




# Y RALTY

## Opatija pjesa e I-rë

**T**akimi, gjatë të cilit njëkohsisht pushojmë dhe mësojmë, për çdo përfaqësues të çfardo niveli distribucioni ka lënë mbresa të veçanta, ngado të ketë ardhur nga rajoni. Të enjten pas mbrritjes të shumë pritur pas një rruge të gjatë zbritëm nga autobuzi të lodhur, por pas panoramës të mrekullueshme që u shpalos na u dëshpërblye lodhja dhe me ngazëllim pritëm ditët me trainim të nivelit botëror dhe me argëtim të veçantë.

### DITA 0 – MË E MIRA E FILLIMIT

Mbasi zumë vend në hotel, hengrëm darkë dhe ndërruam rrobat, filloi pjesa e parë e programit, trainimi ekskluziv i diamant menaxherëve. Në këtë seminar të mbrëmjes vonë, japin idetë e tyre të ndritura **Veronika dhe Stevan Lomjanski, Kati dhe Attila Gidófalvi si dhe Miklós Berkics** për diamantët e ardhshëm. Ndërsa të nesërmen në mëngjes, me bashkpunëtorët e kualifikuar për këtë takim filloi seminari i përmasave më të mëdha të rajonit tonë, ku më të mirët mund të mësojnë rrugën për tu bërë drejtues të sukseshëm.



## DITA E I-RË – NJË ENDËRR E REALIZUAR

Sivjet megjithse në një qendër të re, drejtues të programit ishin dyshja e vjetër **Jadranka Kraljic-Pavletic** – senior menaxhere dhe **Tibor Lapicz** – soaring menaxher. Në sallën me pasqyra të Franc Jozefit, **Dr Sándor Milesz** – drejtor i përgjithshëm hap Holiday Rally-n. Ky është njeriu që prej 16 vjetësh drejton rajonin mjeku alternativ i dekoruar, zëvendës president i Shoqatës Hungareze të Mjekësisë Alternative, zafir menaxher dhe baba i gjashtë fëmijëve. Nën drejtimin e tij tashmë rajoni i Hungarisë dhe i Ballkanit, është bërë një nga rajonet me xhiro vendimtare në rajonin e Europës. „U realizua një endërr” – thotë Dr Sándor Milesz. „Aty ku kanë qëndruar perandorë e perandore, tani janë ulur menaxherë me gurë të çmuar, diamantë e zafir menaxherë, që së bashku ndërtojnë një të ardhshme të fuqishme të mrekullueshme”. pastaj fton në podium të kualifikuarit, mbasi bashkë me ta ndërtohet e ardhmja e Foreverit. „Është një ndjenjë e veçantë të drejtosh një skuadër të tillë fantastike.”

## BAZË E GJITHÇKAJE ËSHTË ALOE VERA

Së pari **Dr Edit Révész Siklósné**, kryetare e Komitetit të Mjekëve Specialistë të FLP Hungari, soaring menaxhere, e cila u takua me mundësitë e FLP më 1999 na flet me detaje për bazat e biznesit tonë dhe për aloe verën. Njerëzimi e njeh aloe verën e familjes të zambakëve prej katër mijë e pesëqind vjetësh, e cila është simbol i shëndetit dhe i bukurisë. Me më tepër se dyqind e dyzet lëndë efektive ajo përmban ndërmjet të tjerash vitaminat, lëndët minerale, aminoacidet dhe enzimat.

„Kriteri më i rëndësishëm i një plotësuesi dietik, është që ai të jetë me përmbajtje natyrale, me një çmim të arsyeshëm, me efekt dhe cilësi të kontrolluar dhe ndërkohë të mos ketë

efekte anësore.” **Dr. Endre Seres** -zafir menaxher, i cili në fillim ishte

skeptik, tashmë që nga viti 1997 është anëtar i Foreverit, tashmë bashkë me bashkëshorten e tij janë një nga çiftet e mjekëve më të sukseshëm në rajon. Tema e tij është qarkullimi i gjakut që për këdo është një fushë e rëndësishme, mbasi sot tek çdo dy vetë njeri vdes për shkak sëmundje të zemrës dhe sistemit të venave. Ndërmjet faktorëve të riskut janë: obeziteti ose shëndoshja e tepërt, ngrenia me yndyrna të tepërta dhe mënyra e jetesës pa lëvizje.

„Cila është zgjidhja? – Parandalimi! Për këtë është shumë i rëndësishëm dekontaminimi dhe pastrimi i organizmit. Temë e **Dr. Terézia Samu** - soaring menaxhere, mjekë konsulente zyrtare e Forever Hungari është: Mënyra e jetës së shëndetshme në FLP.” Gjithnjë e më tepër konsumojmë ushqime të varfëra, dhe padashur bëhemi gjithnjë e më pak rezistentë dhe për pasojë na keqësohet jeta dhe sëmundjet na kapin më shpejtë”. Nga mungesa e vitaminave dhe elementëve të gjurmës (mineralet e rralla) simptomat nuk dallohen por problemet e funksionimit të organizmit herët a vonë çojnë në zhvillimin e sëmundjeve. Ajo që mungon duhet kompensuar, por mundësisht me vitamina natyrale. Prandaj këto vitamina nuk lejohet ti



neglizhojmë, por duhet ti konsumojmë me guxim! Në radhë të parë duhet të vendosim rregull në sistemin tonë tretës. „Tek aloe nuk duhet thjeshtë besuar, por ajo duhet pirë!“

**Dr Ilona Juronics Vargáné**, soaring menaxhere, njëzet vjet mjeke fëmijësh, prej katërmbëdhjetë vjetësh është e lidhur me FLP. Ndërsa **Dr. Endre Németh**, mjek gjinekolog, mjek specialist dhe mjek alternativ, soaring menaxher është mjek konsulent zyrtar i Forever Hungari. Të dy sëbashku kordinojnë pjesën e programit „Përvoja me produktet“, ku distributorët rrëfejnë përvojën dhe eksperiencën e provuar gjatë përdorimit të produkteve të Foreverit.

### NDËRTIM RRJETESH ME BAZË, NË MËNYRË TË VRULLSHME DHE EFEKTIVE

**Ágnes Klaj** soaring menaxhere, që ndërton këtë biznes që nga 2003 na flet për bazat e Foreverit dhe për forcën e 4 pikëshit. „Tu japim njerzve një sistem që dublohet thjeshtë, dhe sipas të cilit do të jenë të sukseshëm! Detyra jonë është të ndryshojmë zakonet e konsumatorëve, prandaj dhe paguhemi.“ Në këtë biznes mund të përparojmë me hapa të thjeshta dhe të lehta, ndërmjet të cilave i pari është realizimi i 4 pikëshit, ata që e realizojnë këtë, u mbetet loja e skuadrës, merr bonusin dhe kualifikohesh, pra kështu ke kuptuar esencën e këtij biznesi. Vetëm duke gjetur 15 vetë që realizojnë 4 pikë në muaj, ti ke arritur nivelin e menaxherit.

Shtyllat bazë të rëndësishme janë sponsorizimi, nisja dhe dublimi. „Duke realizuar 4 pikëshin, bëhemi më të pasur dhe mund të ndikojmë edhe në jetën e të tjerëve.“

**Iskra Rinalda** –senior menaxhere, ka 13 vjet që është lidhur me Foreverin. Foreveri është një biznes i thjeshtë, në qoftë se nuk e komplikojmë ne, beso dy shtyllat kryesore, grupi i produkteve dhe plani i marketingut janë të shkëlqyera, prandaj pa ndonjë risk dhe investim të veçantë mund ti futet kushdo. Mund të arrijmë rezultate të mëdha, në qoftë se përcaktojmë objektivat tona dhe i përvishemi punës me vrull. „Çdo ditë të punojmë dhe të përdorim produktet, gjithmonë të kemi me vete produkte të FLP dhe formular regjistrimi, që gjithmonë të jemi gati për regjistrimin e njerzve të rinj, të cilë në të ardhmen do të jenë konsumatorë apo bashkpunëtorë biznesi. „Vetëm nga ne varet, se çfarë arrijmë në këtë biznes. Duhet të ndryshojmë në interes të asaj, që të bëhemi më të mirë dhe të ecim me këmbngulje drejt realizimit të objektivave tona.“

**Sándor Tóth** - soaring menaxher, që prej 16 vjetësh ndërton sipërmarrjen Forever, na flet për ndërtimin e rrjetit. Të gjithë lindim të lirë, por gjithmonë mbetemi robot të diçkaje, që pengon lirinë tonë. „Foreveri nuk është vetëm një mundësi por edhe një sfidë. Ai që hyn këtu dhe që qëndron këtu, atë njeri ky biznes e transformon. Këtu është koha që ta marrim seriozisht dhe Foreverin ta bëjmë pjesë organike të jetës sonë.“ Tre nivele kryesore ka: supervizor, menaxher dhe Diamant, gjithë nivelet e tjera janë stacione të ndërmjeme.



Ndërkaq në këtë radhë dy pyetje kryesore shtrohen për ta filluar: pse do ta filloj dhe si do ta filloj. Njeriun e vë në lëvizje dëshira, të cilën duhet ta formulojë vetë çdo njeri. Duhet menduar, besuar dhe vepruar!

Tema e menaxherit **Nesic Vitomir** është ndërtimi skuadrës. „Që mund të ecim përpara kanë shumë rëndësi endërrat tona, të besojmë tek ky biznes që na çon drejt e në parajsë.“ Mundësitë e Foreverit duhet të mbrijnë tek çdo njeri, por jo njëjloj, sepse njeri ndryshon nga tjetri. Duhet të punojmë me pasion, me besim dhe me dashuri ndaj njerzve, sepse vetëm atëhere do të lidhen me ne. Ai që dyshon edhe tek vetja, ai nuk do të ketë pasues. Ti bëjmë ballë çdo sfide, sepse nga bashkpunëtorët vetëm atë mund të presim, çka ata shohin tek ne. Është me rëndësi të zbulojmë tek njerzit, ata që kanë veti ta ndërtojnë këtë biznes.

### **SHEMBUJT E KOHËS SONË**

**István Halmi**, diamant-zafir menaxheri, që ka 15 vjet me FLP, ndan me ne përvojën lidhur me ndërtimin e biznesit familjar. „Është e vërtetë se veprimet tona, po ashtu edhe fjalët, flasin me zë të lartë, jo vetëm në biznes por edhe në jetën familjare.“ Si fëmijë kishte dy dëshira: të ishte milioner dhe të kishte një djalë që ti ngjante atij. Kjo u arrit, ai është babai krenar i dy djemve, i Bence dhe i Bajnok. Shembulli personal nuk është një nga mënyrat, por e vetmja mënyrë e edukimit.“ **Bence Halmi**, që ftohet nga i ati të vijë në podium, si fëmi ishte i interesuar kryesisht për shahun, por disa vite më vonë me kualifikimin e tij si menaxher, bëri që edhe prindërit të kualifikoheshin diamant-zafir. Edhe rezervat janë siguruar, sepse sipas Bence edhe vëllai i tij më i vogël do të jetë nga më të mirët në FLP.






**Aranka Vágási**, diamant-zafir menaxhere, ish sportiste e dalluar, e cila në moshën 28 vjeçe kishte 3 diploma, që nga 1997 bashkë me familjen përfaqson Foreverin. „Pjesa dërmuese e njerzve flasin por vetëm një përqindje shumë e vogël veprojnë. Merr në dorë fatin tënd! Ty të takon niveli i menaxherit! Gjithçka , që e do shumë, atë bëje!“ Niveli i menaxherit arrihet me 3-4 supervisorë dhe ai që arrin menaxher , ai tashmë „përmendsh“ mund të nxjerrë menaxherë..„Foreveri është mision i mënyrës të jetesës“. Lëz, vepro!

Është falë punës këmbngulëse të zafir menaxherit **József Szabó**, që në verën e 1997 filloi historia e FLP Hungari. Duke ndjekur endërrën e tij, mbas një viti e gjysëm u krijua edhe tek ne një nga rrjetet e xhiros më të madhe në botë. „Rruga deri tek suksesi është e shtruar me gurë të panumurt përvoje“ Cila është më e keqe: të ndeshesh me falimentin apo të mos e provosh kurrë? „Provo të mendosh gjithmonë pozitivisht dhe në çdo gjë të kërkosh zgjidhjen.“ Në qoftë se do të duam rezultat tjetër nga ky që kemi arritur deri sot, atëhere diçka duhet të bëjmë ndryshe. Ky biznes kërkon ndryshim, dhe në qoftë se jemi gati atëhere do të lumturohemi me të. Diamant menaxherët **Kati dhe Attila Gidófalvi** karrierën e tyre në Forever filluan ta ndërtojnë në 2008, dhe qysh atëhere gati në çdo biznes kanë thyer rekorde. Sot janë një nga rrjet ndërtuesit më të mirë në botën e FLP. Së pari ngjitet në skenë Kati Gidófalvi. „Dy gjëra janë shumë të nevojshme në jetë, të kemi sa më shumë kohë të lirë dhe mjaft para për ta shfrytëzuar atë. Është një lajm i mirë që kush i dëshiron ato, vendi më i mirë i tij është këtu në FLP.“ Në qoftë se njeriu mëson si të silllet mirë me forcat e tij dhe ka besim në vetvete, atëhere ai gjykohet i sukseshëm për

këtë biznes. Mundësitë e këtij biznesi duhet ti trajtojmë si mundësi të jetës sonë, dhe për këtë kushdo duhet të gjejë motivimin e tij. Pastaj nga bashkshortja e merr mikrofonin Attila Gidófalvi. „Nga supervisorët vetëm dyzet përqind arrijnë menaxherë. Objektivi duhet të jetë brënda këtij grupi, por ai mund të arrihet vetë si lojë në skuadër. Për të rinjtë duhet të na tërheq vemendjen, që ta meritojnë kohën e sponsorizimit tonë, që të punojnë si duhet.“

Fillimi i mbarë ka shumë rendësi për njerzit, ata duhet ti futim në situatë, ashtu sikurse kanë vepruar me ne edhe sponsorit tanë. Ti shfrytëzojmë seminarët si person i tretë, dhe kështu ata bëjnë detyrën e tyre, në qoftë se tërheqin mjaft njerëz. Të gjithë kanë në dispozicion të njëjtën kohë, 86400 sekonda në 24 orë, dhe varet nga ne si e shfrytëzojmë kohën, sepse koha nuk pret askënd. Çdo sekondë që nuk shfrytëzohet për arritjen e endërrave tona, është kohë e humbur.



*Përmbledhja aktiviteteve të ditës së dytë të Holiday Rally në Opatija do të vazhdojë në numerin e ardhshëm të revistës.*

# BERKICS MIKLÓS

# FOREVER

# DIAMOND

# TRAINING

**BUDAPEST** 12-13 TETOR 2013

NGA SLOVAKIA DHE ÇEKIA,  
RUMANIA E SERBIA, KROACIA,  
BOSNJE-HERCEGOVINA, MALI I  
ZI, SLOVENIA, SHQIPËRIA DHE  
SIGURISHT NGA HUNGARIA:  
TAKOHEN PËRSËRI NË BUDAPEST  
ATA DISTRIBUTORË, QË E DINË ÇDO  
TË THOTË, QË GJATË DY DITËVE TË  
DËGJOJNË NJEHERAZI DIAMANT  
MENAXHERËT E RAJONIT, MADJE  
EDHE LEKSIONE EKSKLUZIVE NGA  
TRAINUES TË NJOHUR NË MBARË  
BOTËN. PËRSËRI NË SALLËN SYMA,  
PËRSËRI TRAINIM I DIAMANTËVE  
TË FOREVERIT NËN DREJTIMIN E  
DIAMANT MENAXHERIT MIKLÓS  
BERKICS DHE TË DREJTORIT TË  
PËRGJITHSHËM TË HUNGARISË  
DHE TË RAJONIT TONË DR SÁNDOR  
MILESZ.





## KATI GIDÓFALVI – DIAMANT MENAXHERE

***Çifti Gidófalvi filloi këtë biznes në 2008 të sponsorizuar nga Miklós Berkics, dhe brënda 39 ditëve u bënë menaxherë, mbas 4 muajsh soaring menaxherë, mbas 1 viti diamant-zafir dhe mbas një viti e gjysëm Diamant menaxher, duke fituar titullin „Distributorët më të mirë në botë“.***

„Çdo të thotë të nisësh në rrugën e Foreverit? Në shumicën e rasteve më lehtë zgjedhim gjërat e njohura, megjithse mund të mos jenë me aq avantazh, por një herë ia vlen të provosh të panjohurën. Duhet të jemi të hapur, të marrim një vendim për të ardhmen më të parashikueshme, për rezultate më të larta. Së pari ju duhet të siguronit një lloj angazhimi: duhet ta vini në plan të parë të jetës suaj këtë biznes, mbasi për interesin tuaj dhe të fillove. S'ka rëndësi, se nga vjen, ke qënë diplomat, apo sa vjeç jeni, shansi është njëllë për të gjithë, detyra e njëllë. Përsa i përket bekgroundit mjekësor, marketingut apo cilësisë të produkteve firma nuk ka konkurentë të vërtetë. Megjithatë kur filluam edhe ne kishim frikë, dhe na u desh në radhë të parë të bindim veten. Në vend të dobësisë sonë shfrytëzuam forcën e të tjerëve; mësoni ti shfrytëzoni edhe ju këto mjete! Zbuloni endërrat tuaja, mos lejoni që tju fundosin hallet tuaja!

Këtu për 2-5 vjet punë mund të sigurosh pushimin e 40 vjetëve, kur në vend tjetër edhe pas 40 vjet punë mund të jesh i fundosur. Shfrytëzoni sa më shumë shansin, që të arrini sa më shpejt suksesin! Në këtë punë që ia vlen, në fillim duhet investuar shumë energji. Ta dini që gjithë këtë nuk e bëni për çaste të padëshirueshme, por për shumë e shumë vite të rehatshme. Ndërkaq vjen koha edhe për familjen edhe për ju: sepse ju vjen jeta që njeriu meriton.

Kujtdo mund ti takojë më shumë se sa ka tani, por vetëm për atë duhet të bëjë më shumë ose ta bëjë ndryshe, nga ç'e ka bërë tani. Ju duhet të mblidhni veten! Në fillim edhe nga 100 vetë 77 na thanë jo dhe gati po hiqim dorë. Por para se të hiqim dorë u menduam mirë, biseduam me dikë, i cili nuk ishte dorëzuar, sepse njerzit shumë herë dorëzohen një hap para se të vijë shpërblimi. Mund të kalojnë disa muaj para se të shikosh qartë. rezultati do të vijë, vetëm se për të duhet durim, nuk e di ti apo tjetri do të bëhet Diamant, por me siguri njëri do bëhet Diamant. Do të bëhet ai që guxon të ëndërojë, dhe që e pret me mjaft modesti. Këtu gjithkush starton njëllë, dhe në majën e suksesit ka vende plot. Ju uroj që të hapeni, pranoni ata që janë shembull, dhe fillojani! Kini besim tek vetja, sepse mund të bëheni Diamantë!





#### STEVAN LOMJANSKI – DIAMANT MENAXHER

*Diamantët e parë të rajonit, punën e tyre e filluan në Serbi, kur zyrtarisht nuk kishte akoma zyrë të Foreverit. Më 1998 u bënë menaxherë, më 1999 Soaring, në 2000 Zafir dhe më në fund në 2007 u kualifikuan Diamantë. „Një nga çiftet Diamant menaxher më dinamikë në botë” i karakterizoi ata Dr Sándor Milez.*

„Ndiqni me vëmendje, mbani shënim, praktikoni dhe ushtroni dijet çdo ditë dhe kështu Hungaria dhe rajoni saj mund të jenë më të fuqishmit në Europë! Por në qoftë se nuk doni produktet dhe njerzit por vetëm pikët, asnjë sukses nuk do të arrini.”

#### VERONIKA LOMJANSKI – DIAMANT MENAXHERE

„Po cilat janë gabimet më të shpeshta? Nuk kini besim, nuk jeni të sigurtë tek vetja. Interesohi vetëm për pikët dhe jo për njerzit. Nuk jeni besnik me sponsorin tuaj. Nuk i mendoni deri në fund gjërat që duhet të bëni.

Çdo gjë duhet ta bëni pa nxitim. Për rrjetin stabël duhet punuar çdo ditë, gradualisht. Mos devijoni as gjysëm hapi nga politika e biznesit! I respektoni njerzit dhe mos u sillni me ta në mënyrë agresive! Çelësi i suksesit është: Thirr 10 vetë çdo ditë dhe përgatitu mirë për prezantimin e produkteve! Nuk ke punë tjetër vetëm të gjesh 25 vetë, që mendojnë si ti. Konsideroni veten më të rëndësishmit në botë, por objektivat tuaja të jenë të një niveli më të lartë!

Kur është fjala për të biseduar me njerzit, Harrojini fjalët egoiste, në qoftë se flisni për veten do të humbisni partnerët. Bëni pyetjet që ju interesojnë, por merruni edhe me justifikimet! Ndoshta edhe mbas 10 vjetësh mund të kesh nevojë për ndonjë kandidat për distributor, prandaj kini durim. Ndërkohë që prisni për dikë, kërkoni të gjeni distributorë të rinj!

I shtroni vetes pyetjet: Çfarë dhe sa do të planifikoni për 3 vjetët e ardhshëm? Çfarë objektivash doni të arrini, çfarë bonusu doni të fitoni dhe çfarë do të bëni për këtë?

Alfa dhe omega ime janë 4 pikët e qënies aktive. I siguroni këto pikët që në fillim të muajit, që në pjesën e mbetur të muajit të ndihmoni të tjerët! Unë kam jetuar në atë mënyrë, që edhe kur nuk kam patur bukë, kam dashur të ndihmoj të tjerët – kjo ka qënë strategjia ime dhe falë atyre njerzve unë u bëra Diamante.



## DIETMAR REICHLE – DIAMANT MENAXHER

**Çifti Diamantëve gjermanë më parë ka punuar në sipërmarrje tradicionale. Biznesin e Foreverit e filluan veç e veç, por që nga lidhja e martesës në Grand Canyon, janë më të sukseshëm se kurrë ndonjëherë.**

„Shumë herët isha bindur që si i punësuar, kurrë nuk marr aq sa meritoj, paret e shumta i fiton shefi im. Kështu që pas mbarimit të shkollës hapa kafenenë time. Punoja ditë e natë, por kafeneja u dogj dhe unë nuk e kisha të siguarur dhe kështu mbeta me një borxh të madh. Kafeneja e dytë eci më mirë, por vetëm një objektiv kisha të pakësoj sa më shumë borxhet. Më në fund pas disa vitesh kësaj ia arrita, por kohë të lirë nuk kisha. Nuk shikoja sa po rriteshin fëmijët e mij, sepse kur kthehesha unë, ata i kish zënë gjumi. Atëhere u binda sa i varur është njeriu edhe nga biznesi i vet. Atëhere fillova të punoja në një radio private, por „u bëra tepër i suksesshëm“, më pengonin në punë, mi larguan qëllimet dhe kaq ishte: të fitosh sa më shumë. Më në fund pas 20 vjetësh u njoha me network marketingun. Mendoja se nuk kisha kohë por më ftuan disa herë. Në takimin e parë mora pjesë plot skepticizëm. Lektor i fliste për shumë para, por unë nuk e besova. më në fund më tregoi llogarinë bankare dhe unë nënshkrova formularin e regjistrimit. Kështu filloi ky biznes. U interesova, çfarë do të bëhet në qoftë se unë fokusohem plotësisht në network marketing. Mora vendimin: kjo është e ardhmja ime. Shumë nuk u lidhën me të se e konsideronin me risk, por unë i dogja këto ura. Dija të jep forcë, se deri aty ku kisha qënë i përkushtuar plotësisht në veprimtaritë e mia, kisha qënë i sukseshëm.

Kështu që pas muajit të parë u kualifikova, ndërsa mu deshën 10 muaj për pozicionin e dytë të kualifikimit. Në atë kohë filloi një fushatë shtypi kundër firmës, nuk vinin bashkpunëtorë, prandaj qëndrova më larg. Shkova në një firmë tjetër MLM, në një shërbim financiar. Gjatë 8 muajve arrita në pozicionin më të lartë, por pas 2 vjetësh nuk kisha ndjerë ndonjë kënaqsi. Atëhere mendova se duhet të gjeja një firmë të stabilizuar dhe me produkte të mira. Shikova deri në fund firmat më të mira. Në këtë moment erdhi sponsori im dhe bashkë me të edhe Rolf Kipp: çeku i fitimit të tyre më bindi. Në një training fillestar „Start“ mësova gjithshka për Aloe verën. Vendosa të hyj, por atëhere isha gati pa para. Duke i vendosur të gjitha në një fletë regjistrimi mora 10 kuti familjare Touch, i thirra të gjithë ata që njihja. Shumë më thanë lere këtë punë, por unë e dija se kjo funksionon, dhe se unë në këtë biznes do të arrij Diamant. Pas një viti fitoja 22 mijë Euro, kjo tani nuk mund të më trembte. U fokusova, gjithmonë punoja me objektiv dhe kjo funksionoi. Nga mëngjezi deri në mbrëmje zhvillonim prezantime, dhe duke u rritur çeqet, njerzit shtoheshin nga viti në vit. Pati edhe nga ata, që ikën, por nuk njoh askënd që iku nga Foreveri dhe u bë më i sukseshëm diku tjetër. Unë qëndrova. Gjithkush mund do të dojë, por ata që duan vërtet janë të pakët. Me fokusim, me kënaqsi dhe me punë të fortë.



## CHRISTEL REICHLE – DIAMANT MENAXHERE

„Para Foreverit jeta ime ishte e lidhur me vallzimin, kisha mbaruar dy shkolla për koreografe vallesh (me tim shoq u takuam në një ballo). ushtrohesh shumë, për suksesin punoja çdo ditë. Shumë herë herë isha e lodhur, shumë herë qava, por rezistova sepse e dija që isha e aftë të arrij objektivin tim. Kjo pikërisht si në profesionin tonë: e fillojmë, e bëjmë, shumë vetë na thonë jo, por një herë dikush thotë po, atëhere nisemi bashkë – kështu ishte me çdo figurë të re vallëzimi. Gjithmonë më lartë, më shpejtë... , më në fund një përvoja vetiake e produkteve të MLM na dha krahë. U shërova nga një dëmtim i krahut dhe arrita deri në kampionatin botëror. Ju këshilloj, në qoftë se arritët një objektiv, caktoni objektivin tjetër. Edhe në qoftë jeni rrëzuar një qind herë, ngrihuni një qind e një herë dhe fokusohuni tek objektivin! Sigurisht gjatë dhjetë vjetëve edhe ne kemi bërë gabime. Por tani e di si funksionon Foreveri dhe si jo. Për shembull, ka rëndësi, që njeriu të mësojë: ne kemi mësuar shumë nga miqtë; kurrë të mos ju vijë turp të kërkonit këshilla, që pastaj të jeni ju nga ata që mund tu jepni këshilla të tjerëve.“

# ALLAN PEASE

## Komunikimi fitues dhe biseda fituese kokë më kokë

**Në Trainimin e Diamantëve të Foreverit të Miklós Berkics në Budapest për çdo rast do kemi rastin të ftuar si mik një figurë të njohur që është në vijën e parë në botë, dhe cili na sjell njohuri për ndërtimin e sukseshëm të rrjeteve nga një anë tjetër e botës. Për karakterin e njeriut, për mënyrën e të menduarit burrë-grua, për bisedën kokë më kokë kemi fatin të dëgjojmë Allan Pease, shkrimtarin më popullor në Australi, autorin e disa librave bestseller.**

**A**llan Pease nuk është vetëm një nga autorët më popullorë, por edhe një nga lektorët më gazmor. Me aksionet në skenë, me shumë foto, me shumë shembuj dhe lojë me situatat që aplikon, nuk është e lehtë të përshkruash mbresat që të lë ai; gjëja më e mirë është të kesh mundësinë ta dëgjosh personalisht.

Në këtë mënyrë leksioni bëhet interaktiv, mbasi kërcen pak me muzikën që hyn, kërkon të ketë një lloj drite mbi spektatorët: që të shikojë me kë bisedon. Pastaj na nxit që të krijojmë lidhjet: duke u kapur për dore me ata që janë ulur pranë nesh. Takimi spontan i duarve e ndez sallën, të qeshurat shtohen, kur Allan deklaron: Ai që kishte dorën sipër, ai drejton në këtë lidhje. Në ekran shfaqen fotot. Shohim shtërngim duarsh udhëheqësish të shteteve, dhe për këtë sigurisht na jepet edhe sqarimi frymëzues.


Por kemi ardhur për të „punuar“, të shikojmë si e mendon Allan ndërtimin e rrjeteve!

„Çdo gjë që ndodh në jetë, me statistika mund të përshkruhet me një lloj raporti proporcional. Psh kur skiconi planin e biznesit të njerzve, shikoni ndërmjet tyre sa kanë besim në të. Shumë janë skeptik, sepse janë parapërgatitur që ju doni ti bindni për diçka (të panjohurit janë më pak skeptikë nga miqtë apo të afërmit).

Unë rrjedh nga një familje e varfër e një qyteti të vogël nga Austria e Jugut. Im atë si agjent sigurimesh, shumë herë më merrte me vete, kur donte tu prezantonte produktet zonjave amvisave. E vija re gjatë punës, instiktivisht mund ta kuptonin atë dhe mimikën e tij, dhe në këtë gratë ishin në raport dy të tretat më mirë se burrat – dhe këtë ua vërtetoi me pamje skanerit.“

Në këtë çështje Allan propozon, kurrë mos gënjejemi nga sytë e një gruaje, më mirë thirre në telefon!

Më vonë akoma edhe vetë Allani fëmi u angazhua në veprimtari biznesi: shiste sfungjer nëpër shtëpi (atëhere pastronin vetëm me lecka). Vuri re, që treguesi i të qenit i sukseshëm në perspektivë mund të përshkruhet kështu: 10-7-4-2, domethënë



në qoftë se trokit në në 10 dyer, 7 prej tyre ta hapin derën, 4 të dëgjojnë dhe vetëm 2 blejnë. Me këtë djaloshi shitës fitonte 40 dollar. „Atëhere u binda se edhe përgjigjet „jo“ ishin para, mbasi logaritmi gjithmonë funksiononte: në qoftë se trokisja sa duhet në derë, gjithmonë zhvilloja një bisedë, dhe që nga ky çast nuk më interesonte më dështimi“ Dhe prej këtej vjen esenca e këtij biznesi: si mund të trokasësh në njësinë e kohës në sa më shumë dyer për të maksimalizuar fitimin e një ore kohë!

Si djalë i rritur Allan iu kthye profesionit të sigurimeve, këtu funksiononte ligjshmëria 5-4-3-1: domethënë në qoftë se bisedoje me 5 vetë, 4 të prisnin personalisht, 3 të dëgjonin deri në fund dhe vetëm 1 të thoshte „po, dhe me këtë po fitoje 300 dollarë. „Ju çfarë statistike keni pyet Allan Pease dhe qetëson këdo: „raportet proporcionale janë të qëndrueshme, pavarësisht nga aftësitë. Sigurisht raporti proporcional i suksesit mund të rritet: në qoftë bëjmë një seleksionim më të mirë, nuk do të kemi kaq refuzime. Sistemet MLM karakterizohen nga raportet proporcionale të suksesit 10-6-3-1, domethënë në qoftë se shikojmë një numer të madh rastesh, vëmë re se nga 10 telefonata „po“, 6 vetë vijnë në takim, nga të cilët 3 nënshkruajnë, por vetëm 1 fillon të punojë faktikisht. Sigurisht kjo është një lloj shifre e maksimalizuar, për një rrjet ndërtues fillestar ky raport do të jetë edhe më i ulët.

Pastaj lektori pyet audiencën, vallë në cilën shifër duhet të përqëndrohemi, cila është më e rëndësishme për ne? Zemra na thotë të përqëndrohemi tek 1-shi, mbasi 1-shi do të jetë bashkpunëtori aktiv. Mirë po, vetëm se nuk dihet, cili prej tyre do të jetë ai (shumë herë ndodh, që do të jetë ai që nuk

na i ka marrë mendja), prandaj Allan thekson se 10-a është më e rëndësishme, domethënë me atë duhet të merremi, mbasi mbi atë do të kemi ndikimin më të madh. „Në qoftë se përqëndrohemi tek 1-shi, biem në oshilacionin e ndjenjave: ky 1-shi është një zhgënjim konstant.”

Allan Pease na premton jo pak, se në qoftëse për 2 javë bëjmë atë që thotë ai, biznesi ynë do të rritet. „Është i thjeshtë, por jo i lehtë” – nënvizon ai, pastaj na jep një këshillë surprizë: „Do të donit tani ti siguronit kualifikimet?”

Të përmirësoni treguesit e efektivitetit? Organizoni takim me klientët e mundshëm të vitit të ardhshëm, që këtë vit!”

Dhe prej këndej kalon tek komunikimi dhe biseda sipas individëve. „Për njerzit është e rëndësishme ajo që flet për ata, prandaj pyeti ata dhe prano përgjigjet e tyre me jo më shumë se tre përhëndetje me kokë.” Pyetjet që ia vlen të bësh janë: Cila është prioritare që të udhëheq në jetë? Pse pikërisht ajo? Është e rëndësishme për ty? Pse? Cila do të ishte pasoja në qoftë se nuk do ta disponoje? Do ishte i shqetësuar? Pse?

Prej këndej jemi vetëm vetëm një hop, por me rëndësi kyçe për zbulimin e motivimit të tij. Allan na jep një listë të plotë nga mundësitë: të ardhurat dhe liria financiare, biznesi personal, më shumë kohë e lirë, zhvillimi profesional, ndihma e të tjerëve, shtimi njohjeve, pensioni. Listën mund ta bëjmë duke hapur kartat para tij, dhe vetë kandidati mundshëm të zgjedhë.

„Gabimi më i madh, është në qoftë doni që edhe të tjerët të kenë motivimet tuaja. Ka rëndësi që ai vetë të shprehë motivimin e vet, ndryshe do të kundërshtojë. Në qoftë se dikush të refuzon, kjo ndodh sepse ju i keni thënë diçka. Në vënd të kësaj bëni 5 pyetje, pastaj përmbliidhni ato që tha njeriu ynë. Tregoi atij ndihmën tënde, ndërtoje këtë me fjalët e tij. Në qoftë

se nuk është në gjëndje ti jap përgjigjet e duhura për pyetjet themelore, hiq dorë prej tij. Ty të duhen njerëz me zjarr! Ai që është i vakët, a inuk të duhet, të tillë ka plot.

Natyrisht nga Allan Pease marrim një mini kurs për bisedën me individë (duke pasqyruar pasqyrimin e ndjenjave të veta). „Shikoni, çfarë tregojnë shenjat, dhe duke u vendosur në situatën e dhënë bindesh se çfarë mendon ai tjetri! Për këtë rëndësi të madhe ka bindja nga diskutimi sy më sy.” Dihet se duart e lidhura do të thonë vetkontroll, dora e mbajtur para gojës sekretin e diçkaje, ndërsa bërja me kokë vëmendje aktive ndaj atij që flet.

„Kërkoni sulmin ose shenjat e miqësisë – kjo ndodh në çdo takim, edhe në botën e kafshëve. Kur buzëqesh, gjithkush të kthen buzëqeshjen dhe kjo faktikisht gjeneron një atmosferë të gëzuar edhe atëhere kur në fillim ka qënë si sforcim.”

Marrim një shpjegim shkencor edhe për atë që nga përvoja tashmë të gjithë e dimë: situatat gjykohen ndryshe nga burrat dhe ndryshe nga gratë, truri i tyre ndryshon. Gratë e lexojnë më mirë mimikën, janë të afta të flasin njëkohsisht dhe ta shikojnë më parë në fytyrat e tyre atë që do të thonë. Burri nuk do të mendojë për asgjë, ndërsa nuk i pëlqen në qoftë se prej tij presin leximin e mendimit. Ose i flet ose e dëgjon tjetrin dhe nuk i pëlqen të përzihen të dyja. Ndërsa gratë çdo ditë thonë 20-24 mijë fjalë, burri e shumta thotë 11 mijë fjalë. Po kështu Pease thekson: nga 5 vetë vetëm 3 janë të një stereotipi të vërtetë, i katërti lëkundet, ndërsa një del nga radha. Kështu përshembull nga 5 gra, 1 ka „tru burri” dhe e kundërta

„Dënimi i vërtetë për një burrë nuk është fjala „fli në divan”, por fjala „na fol për ndjenjat e tua” – thotë duke u larguar me të qeshur autori i sukseshëm.

## LEKTORI

**Allan Pease është autori më i sukseshëm në Australi. Ka botuar 17 libra bestseller në 26 milion kopje. Ka mbajtur leksione në 66 vende të botës. Ka qënë menaxher i shitjeve në firmën broker të sigurimit të jetës në Gjermani, trainues zyrtar i menaxhimit, ndërsa sot drejton shkollën e vet.**



**D**rejtues të programit ishin soaring menaxherët **Vesna dhe Siniša Kuzmanović**, të cilët në këtë biznes në fillim hynë si konsumatorë, por shpejt panë rezultatet e mëdha të të tjerëve dhe vlerësuan mundësitë që fshiheshin në ndërtimin e rrjeteve. Me FLP është lidhur gjithë Europa, kanë ndryshuar jetën e vetë dhe të familjeve të tyre, dhe sipas synimeve në këtë biznes do të donin të qëndronin përgjithmonë – Forever!

**Dr. Branislav Rajić**, menaxher, drejtues i FLP Serbi, foli për aktivitetet më të reja të firmës sonë. Firma ndjek me kujdes zhvillimet më të reja dhe „si pionere e tregut“ ka nisur programe të reja stimulimi, dhe ka thjeshtëzuar proceset e biznesit. Stimuli më i fundit është programi „Londra na Thërret“, që na bën të mundur, të jemi pjesmarrës në takimin e ardhshëm global.

# SUCCESS DAY

NË DITËN E SUKSESIT TË VJESHTËS NË BEOGRAD MUNDËN TË TOKOHEN  
DISTRIBUTORË NGA SERBIA DHE NGA SHTETET E RAJONIT.

BEOGRAD, 29 SHTATOR 2013





